



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË



Sheshi "Skënderbej", No. 1, Tirana - Albania • **Tel:** ++355 4 222230; 222750; 235568
• **Fax:** ++355 4 223558 • **Website** www.bankofalbania.org • **E-mail:** public@bankofalbania.org

Tiranë, 13.07.2004

DEKLARATË PËR SHTYP

ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË PËR TREMUJORIN E PARË TË VITIT 2004

Bilanci i pagesave të Shqipërisë, gjatë tremujorit të parë të vitit 2004 në krahasim me tremujorin e parë të vitit të kaluar, është karakterizuar nga këto zhvillime kryesore:

- Rritje e vëllimit të transaksioneve korente;
- Thellim i deficitit korent dhe atij tregtar;
- Rritje e eksporteve me një ritëm më të lartë se importet;
- Pakësim i transfertave kapitale dhe i investimeve të huaja;
- Rritje e njëkohëshme e mjeteve dhe e detyrimeve të huaja dhe rritje e rezervave valutore të autoritetit monetar.

Deficiti korent për tremujorin e parë të vitit 2004 ishte –74.6 milionë dollarë ose 2.3 herë më i lartë sesa deficiti prej -32 milionë dollarësh i regjistruar gjatë tremujorit të parë të vitit 2003. Megjithatë, në krahasim me tremujorin e paraardhës, ky tremujor ka regjistruar zhvillime pozitive përsa i përket madhësisë së deficitit korent dhe deficitit tregtar. Në fund të tremujorit të parë të vitit 2004, deficiti i tregtisë së jashtme në mallra dhe shërbime shënoi 320 milionë dollarë. Rreth 80 për qind e këtij deficiti u mbuluar nga bilanci i përbashkët pozitiv prej 246 milionë dollarësh në kategoritë 'të ardhura nga puna' dhe 'transferta korente'. Deficiti korent prej -74.6 milionë usd u financua pjesërisht prej hyrjeve neto kapitale dhe financiare, të cilat kapën shifrën 59 milionë usd. Nga këto, 34 milionë dollarë kanë qenë hyrje në formën e transfertave kapitale (grante, kredi të buta etj.) dhe 25 milionë dollarë hyrje neto në llogarinë financiare. Detyrimet financiare neto të Shqipërisë gjatë këtij tremujori u rritën me 88 milionë dollarë, ndërsa mjetet e huaja në pronësi të rezidentëve u rritën me 62.5 milionë dollarë.

I. LLOGARIA KORENTE

Fluksi i shkëmbimeve korente të Shqipërisë me botën, gjatë tremujorit të parë të vitit 2004, kapi shifrën 1.28 miliardë usd, e cila është 22.6 për qind më e lartë se ajo e një viti më parë. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes së shkëmbimeve tregtare në mallra dhe në shërbime, ndërkohë që kategoritë e të ardhurave dhe të transfertave korente kanë mbetur pothuajse të pandryshuara në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2003.

a) Bilanci tregtar

Vëllimi i përgjithshëm tregtar gjatë periudhës u vlerësua në 588 milionë usd ose rreth 85 milionë dollarë më i lartë se ai i të njëjtës periudhë për vitin 2003. Transaksionet tregtare përfaqësuan 46 për qind të transaksioneve korente. Importet e kësaj periudhe, duke shënuar 451 milionë dollarë, i tejkaluan ato të vitit të kaluar¹ me rreth 14 për qind, ndërkohë që eksportet (136 milionë dollarë), pavarësisht nga rritja prej 26 për qind, nuk arritën të ngushtonin deficitin tregtar. **Megjithatë duhet vlerësuar fakti që eksportet e mallrave për këtë tremujor, kanë shënuar nivelin më të lartë të eksporteve për tremujor në vite.** Deficiti tregtar, në mbyllje të tremujorit, ishte 315 milionë usd ose 10 për qind më i lartë sesa ai i periudhës korresponduese të vitit paraardhës. Analiza e dinamikës strukturore të importit nxjerr në pah rritjen e vazhdueshme të importeve në mallra kapitale, si dhe në mallra për përpunim aktiv. Gjithashtu e lartë mbetet kërkesa për mallra ushqimore. Kontributin kryesor në rritjen e eksporteve shqiptare e kanë dhënë riekportet (eksporte me material porositësi), të cilat dominojnë eksportet shqiptare, duke zënë aktualisht 81 për qind të vëllimit të përgjithshëm të tyre. Të ardhurat nga eksportet e kësaj kategorie vlerësohen 32 për qind më të larta kundrejt tremujorit të parë të vitit të kaluar. Megjithatë, kjo industri karakterizohet nga një numër i kufizuar produktesh për përpunim. Eksporti nga prodhimi i brendshëm ka shfaqur ecuri të ngadaltë. Shkalla e përfaqësimit të tij në eksportin total vlerësohet në 19 për qind.

¹ I referohemi gjithnjë tremujorit të parë.

b) Shërbimet

Llogaria e shërbimeve për tremujorin e parë të vitit u mbyll me një bilanc negativ prej 6 milionë dollarësh. Në krahasim me tremujorin e parë të vitit të kaluar, i cili u mbyll me një suficit prej 4 milionë dollarësh, ky tremujor ka regjistruar rritje të deficitit në shërbimet e transportit dhe ngushtim të suficitit në shërbimet e turizmit.

Eksportet e shërbimeve kapën shifrën 197 milionë dollarë, ndërsa importet 203 milionë dollarë. Si në të ardhurat, ashtu edhe në shpenzimet për shërbime, peshën më të madhe vazhdojnë ta zënë shërbimet e turizmit. Gjatë tremujorit të parë të vitit rezidentët kanë shpenzuar 123 milionë dollarë jashtë vendit për turizëm, ndërkohë që të ardhurat nga turistët e huaj janë vlerësuar 136 milionë dollarë. Si të ardhurat ashtu edhe shpenzimet për turizëm për tremujorin e parë të vitit 2004 kanë qenë mjaft më të larta

se sa ato të vitit të kaluar. Në të njëjtën kohë këto vlera janë dukshëm më të ulëta sesa vlerat e regjistruara në tremujorin e katërt të vitit 2003. Pagesat e rezidentëve për shërbime transporti kanë qenë më të larta se sa të ardhurat nga sigurimi i këtyre shërbimeve. Në shërbimet e tjera vërehet rritje e të ardhurave nga shërbimet e komunikacionit.

c) Të ardhurat

Të ardhurat dhe pagesat e rrjedhura nga puna e punonjësve sezonalë, si edhe nga pagesat hyrëse apo dalëse për interesat mbi investimet e natyrave të ndryshme paraqiten në llogarinë e të ardhurave. Ekonomia shqiptare përfiton të ardhura në valutë prej punës së punonjësve sezonalë dhe investimeve të rezervave valutore të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente, dhe njëkohësisht paguan interesat për borxhin e jashtëm. Bilanci i të ardhurave për tremujorin vazhdon të jetë pozitiv duke shënuar 36 milionë dollarë.

Të ardhurat nga puna (22 milionë usd) në krahasim me tremujorin e parë të vitit të kaluar kanë mbetur të pandryshuara. Të ardhurat nga investimet e portofolit (8 milionë usd) dhe të rezervës (10.5 milionë usd) kanë regjistruar një rritje të lehtë në krahasim me tremujorin e parë të vitit të kaluar.

d) Transfertat korente

Llogaria e transfertave korente e mbylli tremujorin me një bilanc pozitiv prej 210 milionë dollarësh. Ky bilanc është i njëjtë me atë të tremujorit të parë të vitit 2003, por rreth 12 për qind më i ulët sesa bilanci i transfertave korente për tremujorin e fundit të vitit 2003. Peshën kryesore (rreth 85 për qind) të të ardhurave në këtë kategori vazhdojnë ta zënë transfertat e emigrantëve shqiptarë me banim jashtë. Gjatë kësaj periudhe këto transfertat kanë arritur nivelin 194 milionë usd. Bilanci pozitiv i transfertave korente ka mbuluar 72 për qind të deficitit në mallra dhe shërbime për tremujorin e parë të vitit.

II. Llogaria kapitale dhe financiare

Flukset neto të kapitalit, gjatë këtij tremujori, regjistroan 59 milionë dollarë. Pas kësaj shifre pozitive, qëndrojnë transfertat kapitale hyrëse prej 34 milionë dollarë dhe bilanci pozitiv i llogarisë financiare prej rreth 25 milionë dollarë.

Bilanci i llogarisë financiare për tremujorin ishte 25 milionë dollarë, gjë që do të thotë që gjatë kësaj periudhe Shqipëria ka regjistruar hyrje neto kapitali. Llogaria financiare ka regjistruar një rritje neto të detyrimeve prej 88 milionë dollarësh. Rritja e detyrimeve ka ardhur kryesisht prej flukseve hyrëse të investimeve direkte (34 milionë dollarë), prej rritjes së borxhit të jashtëm zyrtar (me 27.5 milionë dollarë) dhe prej rritjes së depozitave të jorezidentëve në vend (10 milionë dollarë). Nga ana tjetër, pretendimet e rezidentëve ndaj jorezidentëve gjatë tremujorit janë rritur me 62.5 milionë dollarë. Rritja e mjeteve është përcaktuar kryesisht nga lëvizjet në depozitat e njësive rezidente jashtë (rritje me 41 milionë dollarë) si edhe nga rritja neto në mjetet e tjera. Një rritje e të njëjtës masë në depozitat e rezidentëve jashtë është regjistruar edhe në tremujorin e tretë të vitit të kaluar, ndërkohë që tremujorët e tjerë kanë shënuar ulje ose ngritje të lehta.

Rezervat valutore të autoritetit monetar gjatë tremujorit të parë të vitit u rritën me rreth 15 milionë usd, rritje që erdhi pjesërisht nga rritja në mjetet valutore dhe pjesërisht nga rritja në zotërimet në SDR. Stoku i rezervave vlerësohet në 1 miliardë e 28 milionë usd dhe mbulon 4.7 muaj importe të mallrave dhe shërbimeve.

Bilanci i Pagesave

në milionë dollarë amerikanë

	3m-I 2003	3m-I 2004
Llogaria Korente	-32.3	-74.6
Eksporti i mallrave	108.5	136.5
Importi i mallrave	-394.0	-451.3
Bilanci Tregtar	-285.5	-314.8
Shërbimet: Kredi	129.0	196.6
Shërbimet: Debi	-125.0	-202.6
Të Ardhurat: Kredi	44.0	41.6
Të Ardhurat: Debi	-5.1	-5.3
Transferta Private Pashpërblim	198.1	196.8
Transferta Shtetërore Pashpërblim	12.1	13.0
Llogaria Kapitale	31.0	34.0
Llogaria Financiare	50.0	19.1
Investime Direkte	38.0	35.0
Investime Portofoli	-12.1	-1.3
Kapitale të Tjera*	18.6	-20.5
Gabime dhe Haresa Neto	2.8	30.3
Bilanci i Përgjithshëm	57.0	14.9
Rezervat dhe Zëra të Lidhur me to.		
Mjetet e Rezervës	-57.0	-14.9
Përdorim Huash e Kredish nga FMN	5.5	6.0
Për t'u Mbajtur në Vëmendje		
Ndryshimi Total në Rezerva	-67.7	-2.6
nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit	10.7	-12.3

*/ nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN

Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë.